



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 17.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. EYIAAF-0096, për zyrtaren znj. Afërdita Beka - Arifaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur me pretendime për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimi të denoncimit nga disa raportues, ka filluar procedurën e shqyrtimit të konfliktit të interesit.

Denoncuesit e rastit kanë ngrit pretendimet për konflikt interesi, citojmë pretendimet nga kërkesat e tyre;

“Zyrtari Rigon Mustafa është emëruar U.D i Udhëheqësit të divizionit të teknologjisë informative, dhe në mungesë të Udhëheqësit të departamentit të shërbimeve të përgjithshme i raporton drejtpërdrejt zyrtarit Kryesor Administrativ Aferdita Beka Arifaj, që krijon përceptim të konfliktit të interesit. Sipas pretendimit të raportuesit Rigon Mustafa është djali i kusherit të parë të babait (baba i Aferdites dhe baba i Rigon Mustafes janë kusheri të parë, djali i dajës i babës). Rigon Osmani është familjar i vetë znj. Arifaj, ka edhe fakte që ju kanë dërguar komisionit por nuk ka pas asnjë reagim. Përveç që është manipuluar komisoni zgjedhor për pranimin e tij në punë, pas 6 muajve pa e pasur shkollimin adekuat dhe aq me pak përvojën e punës menaxheriale e bënë ushtrues detyre të Udhëheqësit të II – së”.

Agjencia, bazuar në nenin 22 paragrafi 5 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, e ka njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me qëllim të sqarimit të gjendjes faktike, ka kërkuar dhe pranuar dokumentacion përkritazi me rastin konkret.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar gjendja faktike si në vijim;

Zyrtarja e lartë znj. Afërdita Beka – Arifaj, përmes shkresës zyrtare të datës 19.06.2025, ka ofruar sqarimet lidhur me pretendimin e ngritur për konflikt interesi.

Kërkesa për iniciimin e shpalljes së konkursit të pozitës Dizajner Grafik në Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës është bërë me datë 20.05.2024 dhe është aprovuar nga Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Konkursi për pozitën Dizajner Grafik është shpallur me datë 23.05.2024.

Komisioni rekrutues është formuar me vendimin nr.00972/24 të datës 10.07.2024 nga Drejtoresha Ekzekutive në Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 16.07.2024 ka shpallur rezultatin përfundimtar të procedurës së rekrutimit ku është përzgjedhur kandidati Rigon Osmani.

Akt emërimi ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit për pozitën Dizajner Grafik është nënshkruar me datë 03.09.2024.

Rigon Osmani është caktuar U.D. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun me vendimin nr.00686/25 të datës 28.03.2025 nga Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, dokumentacionit dhe sqarimeve të mbledhura sipas detyrës zyrtare konstaton se;

Vështruar nga aspekti administrativ i rregullimit dhe përcaktimit me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për personat e afërm.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka **interes privat**, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së **interesit të tij privat** ose të **personave të afërm** me të*

lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”*.

Në nën paragrafi 1.6, të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar se: *“Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë [...]”, si dhe me nënparagrafin 1.12 të këtij neni, i cili e definon nocionin vendimmarrje si: “**çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik**”*.

Me qëllim të verifikimit të lidhjes familjare ndërmjet Afërdita Beka – Arifaj dhe Rigon Osmani, Agjencia ka kërkuar informacion nga Agjencia për Regjistrim Civil.

Agjencia për Regjistrimin Civil në përgjigjen e ofruar ka konstatuar se nuk është gjetur lidhje familjare ndërmjet tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet e raportuesve për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, kjo për faktin se nuk është gjetur lidhje familjare ndërmjet tyre, e as interes privat në vendimmarrje të procedurës siç parashihet në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ka trajtuar vetëm pretendimet për konflikt interesi, ndërsa pretendimet për shkelje të tjera të kësaj procedure të rekrutimit, nuk ishin objekt shqyrtimit sepse nuk hyjnë në kuadër të kompetencave së Agjencisë.


II Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: palët e pakënaqura kanë të drejtë të inicojnë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtares publike
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit